



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VLORË

V E N D I M

Nr. 16, datë 08.05.2014

**“MBI STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE
VARTËSE – VITI 2014”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të:

- Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma ç, neni 2, pika 2, 3, neni 44, gërma e, ë, f,
- VKM Nr.586, datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.1619, datë 2.07.2008, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.
- VKM Nr.513, datë 01.07.2002 “Për caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe të komunës”
- Ligji Nr. 9780, date 16.07.2007, “ Për inspektoriatin e ndërtimit”, Neni 18:
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”
- VKM Nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”

dhe në referencë të VKM Nr.474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”

V E N D O S I

- I. Të miratojë strukturën, nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të administratës së Bashkisë Vlorë për vitin 2014 deri në miratimin e strukturës të vitit pasardhës. me numër të përgjithshëm 198 (+13), me përbërje si më poshtë (tabela bashkëngjitur)

1. Drejtues	1 person
2. Kabineti i Kryetarit	4 persona
3. Këshilli i Bashkisë	2
4. Administratori i qytetit	11
5. Drejtoria Juridike	4
6. Drejtoria e Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve	4
7. Njësia e Auditimit të Brendshëm	3
8. Drejtoria e Burimeve Njerëzore	6
9. Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun	7
10. Drejtoria e Financë – Buxhetit dhe Kontabilitetit	33
11. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	29
12. Drejtoria e Planifikimit të Territorit	17
13. Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve	16

14. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik	22
15. Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social	10
16. Inspektoriat Ndërtimor Urbanistik	9
17. Policia Bashkiake	20
18. Zyra e Gjendjes Civile	(+10)
19. Qendra e Regjistrimit të Biznesit	(+3)

II. Të miratojë strukturën, nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të institucioneve dhe njërive vartëse si më poshtë (tabela bashkëngjitur – gjithsej 213):

1. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	136
2. Teatri “Petro Marko”	29
3. Qendra e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve	22
4. Klubi Shumësportesh “Flamurtari”	14
5. Qendra e Zhvillimit të PAK	6
6. Shtëpia e Fëmijës	6

III. Të miratojë për 3 (tre) aktorë të estradës me arsim të mesëm (Qytetarë Nderi) kategorinë IV-b me pagën mujore 30.000 lekë (VKM Nr.586, datë 17.7.2013, lidhja nr.2, kategoria IV-b)

IV. Të miratojë shpërblimin mujor të Këshilltarëve të Këshillit të Bashkisë në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë.

V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

VI. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 8652, datë 31.07.2000, neni 33 pika 6.



 Evis ALLUSHI
 KRYETARE

